

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega ne Shqiperi


Raporti i Audituesit Ligjor
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR	3-4
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	9 – 21

STUDIO "AUDIT 411"

Adresa: Rruga "Nikolla Jorgo", Ndërtesa I
Hyrja I, Ap.10, , Tiranë



NIPT: L91310004 V

Telefon: +355 4 2428214,

Mobile: +355 69 20 73030

E-mail: ilir.daiu@audit411.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për : Aksionerët dhe Drejtimin e Subjektit "PWT WASSER UND
ABWASSERTECHNIK " – DEGA NË SHQIPËRI

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Subjektit tregtar "PWT WASSER UND ABWASSERTECHNIK" – DEGA NË SHQIPËRI, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (*ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*), pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të ndryshuara.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e



auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SKK-të, ne ushtrojmë gjykim dhe dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë proceduara auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brëndshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brëndshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brëndshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si edhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në menyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë cdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

AUDITUES LIGJOR
ILIR DAIU

Adresa:

Rruga "Nikolla Jorgo", Ndërtesa I,
Hyrjal, Ap. 10, Tiranë, Shqipëri
Mobile: +355 69 20 73030
E-mail: ilir.daiu@audit411.com
Nr. Liçencës 361

Datë 31/03/2021



PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Bilanci për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK)

AKTIVET		Shenime	Viti raportues	Viti paraardhes	Ndryshimet +/-
I	Aktivet Afatshkurtra				
1	Mjete monetare		724,602,380	681,134,591	43,467,789
-	Arka	1	48,564	20,540	28,024
-	Banka	1	69,473,673	26,033,909	43,439,764
-	Garanci projekti	1	655,080,143	655,080,143	-
2	Derivative te mbajtura per tregtim		-	-	-
-	Derivatet				
-	Aktivet e mbajtura per tregtim				
3	Aktive te tjera afatshkurtra financiare		68,002,280	438,815,012	(370,812,732)
-	Llogari/Kerkesa te arketueshme	2	15,515,543	412,106,754	(396,591,212)
-	Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	2	44,603,177	26,708,258	17,894,919
-	Instrumente te tjera borxhi	3	-	-	-
-	Investime te tjera financiare	3	7,883,560	-	7,883,560
4	Inventari		22,222,007	42,361,472	(20,139,465)
-	Lendet e para	4	22,222,007	42,361,472	(20,139,465)
-	Prodhim ne proces	4	-	-	-
-	Produkte te gatshme	4	-	-	-
-	Mallra per rishitje	4	-	-	-
-	Parapagesat per furnizime	4	-	-	-
5	Aktivet biologjike afatshkurtra				
6	Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje				
7	Shpenzimet e shtyra	2	72,342	2,706,468	(2,634,126)
	Totali per Aktivet Afatshkurtra		814,899,009	1,165,017,543	(350,118,534)
II	Aktivet Afatgjata				
1	Investimet financiare afatgjata		-	-	-
-	Aksione, pjesemarrje ne njesi te kontrolluara				
-	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje				
-	Aksione dhe letra te tjera me vlere				
-	Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata				
2	Aktive afatgjata materiale		908,424	1,191,370	(282,946)
-	Toka	5	-	-	-
-	Ndertesat	5	-	-	-
-	Mobilje dhe paisje zyre	5	238,344	297,930	(59,586)
-	Paisje informatike	5	670,080	893,440	(223,360)
3	Aktivet biologjike afatgjata				
4	Aktivet afatgjata jomateriale		-	-	-
-	Emri i mire				
-	Shpenzimet e zhvillimit				
-	Aktive te tjera afatgjata jomateriale	5			
5	Kapital aksionar i papaguar				
6	Aktive te tjera afatgjata (ne proces)				
	Totali per Aktivet Afatgjata		908,424	1,191,370	(282,946)
	TOTALI I AKTIVEVE		815,807,433	1,166,208,913	(350,401,480)

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Bilanci për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK)

PASIVET		Shenime	Viti raportues	Viti paraardhes	Ndryshimet +/-
I	Detyrimet Afatshkurtra				
1	Derivatet (vlera negative)				-
2	Huamarrjet		-	-	-
-	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	6	-	-	-
-	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	6	-	-	-
-	Bono te konvertueshme				-
3	Huat dhe parapagimet		751,943,124	1,054,965,552	(303,022,427)
-	Te pagueshme ndaj furnitoreve	7	96,481,452	332,811,319	(236,329,867)
-	Te pagueshme ndaj punonjesve	8	-	-	-
-	Detyrimet tatimore	9	381,529	303,136	78,393
-	Hua te tjera	10	655,080,143	658,028,883	(2,948,740)
-	Parapagimet e arketuara	11	-	63,822,214	(63,822,214)
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra				-
5	Provizionet afatshkurtra				-
	Totali per Detyrimet Afatshkurtra		751,943,124	1,054,965,552	(303,022,427)
II	Detyrimet Afatgjata				
1	Huat afatgjata		-	-	-
-	Hua, bono dhe detyrime nga leasing	12	-	-	-
-	Bonot e konvertueshme				-
2	Huamarrje te tjera afatgjata				-
3	Provizionet afatgjata				-
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra				-
	Totali per Detyrimet Afatgjata		-	-	-
	Totali i detyrimeve		751,943,124	1,054,965,552	(303,022,427)
III	KAPITALI				
1	Aksionet e pakices				-
2	Kapitali aksionareve te shoqerise meme				-
3	Kapitali aksionar		-	-	-
4	Primi i aksionit				-
5	Njesite ose aksionet e thesarit				-
6	Rezerva		-	-	-
-	Rezerva ligjore				-
-	Rezerva te tjera				-
-	Rezerva statuore				-
7	Fitimet e pashperndara		111,243,361	77,619,933	33,623,428
8	Fitimi/Humbja e vitit financiar		(47,379,053)	33,623,428	(81,002,480)
	Totali per kapitalin		63,864,308	111,243,361	(47,379,053)
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		815,807,433	1,166,208,913	(350,401,480)

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK)

Nr.	Pershkrimi	Shenime	Viti ushtrimor	Viti parardhes	Ndryshimi +/-
1	Shitjet neto	13	63,639,909	1,223,159,132	(1,159,519,223)
2	Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	14	-	-	-
3	Ndryshimet ne inventarin e P.G dhe P.Proces	15	(74,870,009)	(115,102,410)	40,232,401
4	Puna e kryer nga njesia ekonomike				-
	Totali te ardhurave nga veprimtaria		(11,230,101)	1,108,056,722	(1,119,286,822)
5	Mallrat, lendet e para dhe sherbimet	16	44,896	923,226,638	(923,181,742)
6	Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	17	26,559,163	126,592,882	(100,033,719)
7	Shpenzimet e personelit		8,090,409	10,442,604	(2,352,195)
-	<i>Pagat e punonjesve</i>	18	7,433,157	9,397,044	(1,963,887)
-	<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqerore</i>	18	657,252	1,045,560	(388,308)
8	Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	19	282,946	387,258	(104,312)
	Totali i shpenzimeve		34,977,414	1,060,649,382	(1,025,671,968)
	Fitimi(Humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		(46,207,515)	47,407,339	(93,614,854)
1	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare				-
2	Te ardh. & shpenzimet financiare nga pjesmarrjet				-
3	Te ardhura dhe shpenzimet financiare		(1,171,538)	(7,568,659)	6,397,121
-	<i>Nga investime te tjera financiare afatgjata</i>				-
-	<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	20	(1,003,357)	(3,352,670)	2,349,312
-	<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimit</i>	20	(168,181)	(4,215,990)	4,047,809
-	<i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>				-
	Fitimi (Humbja) para Tatimit		(47,379,053)	39,838,680	(87,217,733)
	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	21	-	6,215,252	(6,215,252)
	Fitimi (Humbja) neto e vitit financiar		(47,379,053)	33,623,428	(81,002,480)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali aksioner	Prime te kapitalit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore & statutore	Fitimi pashperndare	Totali
Pozicioni me 31 Dhjetor 2018	-			-	77,619,934	77,619,934
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabel						
Pozicioni i rregulluar					77,619,934	77,619,934
Fitime neto per periudhen kontabel					33,623,428	33,623,428
Dividentet e paguar					-	-
Rritje e rezerva ligjore & te tjera						
Emetim iaksioneve te kapitalit						
Aksione thesari te riblera						
Pozicioni me 31 Dhjetor 2019	-			-	111,243,362	111,243,362
Fitime neto per periudhen raportuese					(47,379,053)	(47,379,053)
Dividentet e paguar					-	-
Rritje e rezerva ligjore & te tjera						
Emetim iaksioneve te kapitalit						
Aksione thesari te riblera						
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	-	-	-	-	63,864,309	63,864,309

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Viti raportues	Viti paraardhes
Fluksi i parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	(47,379,053)	33,623,428
Rregullime për:		
- Amortizimi dhe zhvlerësimi	282,946	387,258
- Humbje nga këmbimet valutore		
- Të ardhura nga investimet		
- Shpenzime për interesa		
- Rritje/rënie në tepricën inventarit	20,139,465	36,093,861
- Rritje/rënie e kërkesave të arkëtueshme	396,591,212	34,604,531
- Rritje/rënie në tepricën e debitoreve të tjera	(25,778,479)	(1,669,140)
- (Rritja) / Ulja e shpenzimeve të parapaguara	2,634,126	6,225,569
- Rritje/rënie e detyrimeve ndaj furnitoreve	(236,329,867)	(134,289,003)
- Rritje/rënie e detyrimeve ndaj punonjesve	-	-
- Detyrimet tatimore	78,393	(11,989,038)
- Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve të tjera	(66,770,954)	18,929,859
- Paratë e përfuara nga aktivitetet	-	-
<i>Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>	43,467,789	(18,082,675)
Fluksi i parave nga veprimtaritë investuese		
- Blerja e shoqërisë së kontrolluar minus paratë e arkëtuara		
- Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-	(100,834)
- Të ardhura nga shitja e pajisjeve		
- Interesi i arkëtuar		
- Dividendët e arkëtuar		
<i>Paraja neto, e përdorur në aktivitetet investuese</i>	-	(100,834)
Fluksi i parave nga veprimtaritë financiare		
- Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
- Të ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
- Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare	-	-
- Dividendët e paguar	-	-
<i>Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare</i>	-	-
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare	43,467,789	(18,183,509)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	681,134,591	699,318,101
Mjetet monetare në fund të periudhës	724,602,380	681,134,591

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PERFAQESUESI LIGJOR I DEGES

Marcel Antonio Salazar



HARTUESI I PASQYRAVE FINANCIARE

Kazazi Consulting



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria PWT Wasser und Abwassertechnik – Dega në Shqipëri (më poshtë referuar si "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 18 prill 2016.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Shoqëria është degë e kompanisë gjermane "PWT Wasser-und Abwassertechnik GmbH".

Përfaqësues ligjor i shoqërisë është Z. Marcel Antonio Salazar.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është shitja, planifikimi, ndërtimi dhe operimi i impianteve të të gjitha llojeve, veçanërisht i impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm, ujit të konsumit dhe ujërave të zeza të të gjitha llojeve si dhe impiante për trajtimin e mbetjeve dhe për dekontaminimin e sedimenteve të ndotura si dhe impiantet elektro-teknike të të gjitha llojeve.

Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në Njësinë e Tatimpaguesve të Degës së Tiranës me numër identifikimi (NIPT) L61618019A. Adresa e saj e regjistruar është Bulevardi "Gjergj Fishta", Seksioni 3, Shkalla 1, kati i tretë, Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 4 (katër) punonjës.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos regjistrojë tatim të shtyrë në pasqyrat e veta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
US Dollar (USD)	100.84	108.64
Euro (EUR)	123.70	121.77

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktiveve afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen me metodën lineare duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet. Të gjitha aktivitetet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajisjeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

Kategoria e aktivitet	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Ndertime	Mbi vlerën kontabël neto	5%

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuarat të aktivitetit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuara është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuarat të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivitetet jo-financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshme skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria nuk ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë; si dhe nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2020 janë si vijon:

Nr.	Emertimi	Gjendja ne fillim te periudhes	Hyrje	Dalje	Gjendja ne fund te periudhes
I.	Mjete monetare ne ban	108,781,417	491,507,520	448,067,756	69,473,673
1	Raiffeisen Bank ALL	11,871,568	1,183,200	12,956,711	98,057
2	Raiffeisen Bank ALL 1	331,842	44,096,323	966,000	43,462,165
3	Raiffeisen Bank EUR	13,830,499	446,227,997	434,145,045	25,913,452
4	Raiffeisen Bank USD	-	-	-	-
		-	-	-	-
II.	Mjete monetare ne arke	20,540	260,000	231,976	48,564
III.	Garanci projekti	655,080,143	-	-	655,080,143
	Totali	763,928,833	491,767,520	448,299,732	724,602,380

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në lekë dhe valutë me të cilat Shoqëria kryen pagesat si dhe arkëton kërkesat nga të tretët. Garancia e projektit konsiston në një garanci të vendosur

nga kompania mëmë, në një llogari bankare në Raiffeisen Bank, e cila do të jetë e kthyeshme në fund të projektit.

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

Kliente per mallra, produkte e sherbime ne fillim te periudhes	412,106,754
Shtesat gjate vitit (Faturimet)	7,416,069
Pakesimet gjate vitit (Arketimet)	404,007,280
Gjendja e klienteve ne fund te periudhes	15,515,543

Klientët pasqyrojnë vlerën e akumuluar të situacioneve (faturave) që evidentojnë vlerën e shitjeve që shoqëria ka kryer dhe që nuk janë arkëtuar brenda vitit ushtrimor 2020.

Emertimi	Gjendja ne fund te periudhes
Te drejta ndaj kompanise meme (455)	7,883,560
Tatim mbi fitimin (444)	7,878,677
TVSH (455)	36,608,501
Te tjera (467)	32,961
Te ardhura te periudhave te ardhshme	
Te drejta te tjera ndaj Doganes Tirane (446)	83,037
Shpenzime te periudhave te ardhshme (486)	72,342
Totali	52,559,079

6. INVENTARI

Inventari në fund të periudhës ushtrimore 2020 është 22,222,007 LEK, e cila përfaqëson gjëndjen e lëndëve të para më datë 31 dhjetor 2020.

	<u>31/12/2020</u>	<u>31/12/2019</u>
Lende e pare	22,222,007	42,361,472
Totali	<u>22,222,007</u>	<u>42,361,472</u>

Eshtë kryer inventari i mallrave në magazinë më datë 31.12.2019, gjatë të cilit ne nuk kemi qënë prezent, pasi emërimi ynë si Auditues Ligjor është bërë në një datë të mëvonshme, dhe për të cilin nuk kemi verejtje. Dokumentacioni i magazines është mbajtur i rregullt.

Mbi bazën e sondazheve që ne kryem gjykojmë se transaksionet ekonomike gjatë ushtrimit për blerje janë kontabilizuar në mënyrë korrekte sipas Ligjit nr 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.”

7. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Shoqëria nuk ka kryer *Parapagime dhe shpenzime të shtyra* gjatë ushtrimit 2020.

PWT Wasser und Abwassertechnik - Dega në Shqipëri
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh të qëndrueshme 908,424 LEK. Nga kontrollat me zgjedhje të përdorura rezultoi se në aktiv të bilancit paraqiten të gjitha aktivet për të cilën shoqëria ka titull pronësie, se ato paraqiten të vlerësuara me vlerën e tyre të lartës në shoqëri, se ato ekzistojnë realisht, klasifikimi i tyre në elementë të veçantë është bërë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligji “Për Kontabilitetin”. Për të gjitha ndryshimet në Aktive të Qëndrueshme ekziston dokumentacioni përkatës.

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si vijon:

Nr.	Emertimi	Aktive të Trupezuara			Amortizimi			Vlera neto			
		Gjendje 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2020	Gjendje 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2019	Gjendje 31.12.2020	
1	Mobilje dhe paisje zyre	658,683.00	-	-	658,683.00	360,752.90	59,586.00	-	420,338.90	297,930.10	238,344.10
2	Paisje informatike	1,921,937.83	-	-	1,921,937.83	1,028,498.26	223,360.00	-	1,251,858.26	893,439.57	670,079.57
	Totali	2,580,620.83	-	-	2,580,620.83	1,389,251.16	282,946.00	-	1,672,197.16	1,191,369.67	908,423.67

Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupezuara është llogaritur sipas normave të nenit 22 të ligjit 8438 date 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat” Llogaritja e amortizimit është bërë për shumën 282,946 LEK, kontabilizuar edhe në shpenzime.

Sipas llogaritjeve për efektin fiskal shoqëria ka përdorur normat ligjore të amortizimit

9. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Shoqëria nuk ka aktive afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020.

10. TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Të pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

Furnitore për mallra, produkte e shërbime në fillim të periudhës	332,811,319
Shtesat gjatë periudhës kontabel (Blerjet)	99,448,705
Pakesimet gjatë periudhës kontabel (Pagesat)	335,778,572
Gjendja e detyrimeve ndaj furnitoreve në fund të periudhës	96,481,452

Emertimi	Gjendja në fund të periudhës
Sigurimet Shoqërore	186,315
Tatim në Burim	195,214
Totali	381,529

Emertimi	Gjendja në fund të periudhës
Detyrime për garancinë	655,080,143
Totali	655,080,143

Të gjitha këto shuma përputhen me formularet e deklaramit të tyre .

11. PROVIGJIONE AFATSHKURTRA

Shoqëria nuk ka krijuar provigjione .

12. KAPITALI FILLESTAR

Duke qënë Degë e Shoqërisë së Huaj , shoqëria nuk ka kapital.

13. TË ARDHURA NGA SHITJA

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen si vijon:

Emertimi	Gjendja në fund të periudhës
Dorëzim punime dhe shërbime (704)	42,655,883
Shitje mallra (705)	20,242,189
Të ardhura të tjera (708)	741,836
Totali	63,639,909

14. KOSTO E PRODUKTEVE TË SHITURA

Kosto e produkteve të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhet si vijon:

Emertimi	Gjendja ne fund te periudhes
Ndryshimi i gjendjeve të mallrave të blera (603)	20,139,465
Blerje materialesh të para (601)	54,730,544
Totali	74,870,009

15. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore:

Emertimi	Gjendja ne fund te periudhes
Pagat e personelit (641)	7,433,157
Kontributi sig.shoqërore (644)	657,252
Totali	8,090,409

16. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera përbëhet si vijon:

Emertimi	Gjendja ne fund te periudhes
Sherbime nga te trete (611)	18,967,878
Qira (613)	2,760,955
Prime të sigurimit (616)	2,706,480
Shpenzime te tjera (618)	836,171
Shpenzime postare dhe telekomunikacion (626)	352,495
Shpenzime për pritje e dhurata (654)	7,580
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime (657)	681
Tatime e taksa te tjera (633, 632 & 638)	223,109
Të tjera shpenzime rrjedhëse (648 & 658)	703,814
Totali	26,559,163

17. FITIMI / (HUMBJA) NGA KURSET E KËMBIMIT NETO DHE FINANCIARE

Fitimet / (humbjet) nga kurset e këmbimit janë si vijon:

Emertimi	Gjendja ne fund te periudhes
Shërbime bankare (628)	(1,003,357)
Fitime/Humbje nga këmbimet valutore (766 / 669)	(168,181)
Totali	(1,171,538)

19. TATIM FITIMI

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri, norma e tatim fitimit për vitin 2020 është 15%. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Llogaritja e normës së tatim fitimit efektiv për vitin 2020 është paraqitur në vijim:

Te ardhurat dhe shpenzimet	Te ushtrimit	Tatimore
Te ardhurat	63,639,909	63,639,909
Shpenzimet	111,018,961	111,018,961
Shpenzimet e pazbriteshme		756,971
Rezultati Fitim / Humbje	(47,379,053)	(46,622,082)
Humbje e mbartur		-
Fitimi i tatuashem neto		(46,622,082)
Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte		-
Parapagime		7,878,677
Tatimi per t'u paguar		(7,878,677)

Parapagimet gjatë vitit 2020 përfshijnë efektin e kompesimit të parapagimeve tatimore për periudhën nga janari në dhjetor të 2020.

20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TE KUSHTËZUARA

Çështje gjyqësore

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk është përfshirë në procedura ligjore, pretendime dhe çështje gjyqësore me palët e treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e ardhshme e mundshme nuk do të ketë një ndikim material negativ mbi pozicionin financiar, rezultatin e operacioneve apo rrjedhën e parasë së Shoqërisë.

21. PALËT E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikat financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfitime nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.

Në vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020, transaksionet me palë të lidhura i korrespondojnë shumave të huamarrjeve me kompaninë mëmë dhe letrës së garancisë së lëshuar nga kjo kompani në emër të shoqërisë shqiptare.

23. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme të cilat kërkojnë rishikime ose ndryshime në këto pasqyra financiare.

PERFAQESUESI LIGJOR I DEGES

Marcel Antonio Salazar

